



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.9.2023

Nr: 769

Ora: 13:00

VENDIM

MBI PROCESIN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT PËR KANDIDATIN PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, Z. ALBERT BILIM HALILAJ, KANDIDAT I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Sot, më datë 12.9.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4, shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

VËREJ:

Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar pranë KZAZ nr. 11 formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kukës z. Albert Bislim Halilaj. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga KZAZ nr. 11 është përcjellë formulari i vetëdeklarimit të kandidatit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike.

Data: 12.9.2023 Nr: 769
Ora: 13:00



"Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023"

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin për Kryetar të Bashkisë Kukës, për zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Kukës rezulton se, të dhënat e deklaruara nga kandidati nuk përfshihen në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pikat 2, shkronja "b" e 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nëpërmjet postës elektronike, për kandidatin për Kryetar të Bashkisë Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Albert Bislim Halilaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidati për Kryetar për Bashkinë Kukës z. Albert Bislim Halilaj, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", nuk përbën kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

Referuar nenit 33, shkronja "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Për sa më sipër, KZAZ duhet të vazhdojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

PËR KËTO ARSYE:

Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Data: 12.9.2023 Nr: 769
Ora: 13:00



"Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kandidatin për Kryetar të Bashkisë Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023"

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultatit të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatin për Kryetar Bashkie z. Albert Bislim Halilaj për Bashkinë Kukës, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, dhe lejimin e kandidimit të tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI